



PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2025



**BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



**PROGRAMI I PUNËS
SË BANKËS POPULLORE
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
PËR VITIN 2025**

Shkup, dhjetor 2024

Përmbajtja

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	1
AKTIVITETET PROGRAMORE	1
KOMPETENCA LIGJORE 1 – STABILITETI I ÇMIMIT.....	2
KOMPETENCA LIGJORE 2 – STABILITETI FINANCIAR, MBIKËQYRJA DHE NDËRHYRJA E JASHTËZAKONSHME.....	2
KOMPETENCA LIGJORE 3 – MENAXHIMI I REZERVAVE VALUTORE.....	3
KOMPETENCA LIGJORE 4 – SISTEMET E PAGESAVE DHE DISPOZIMI I PARAVE TË GATSHME.	3
KOMPETENCA LIGJORE 5 – HULUMTIMET EKONOMIKE DHE STATISTIKA.	4
KOMPETENCA LIGJORE 6 – QEVERISJE DHE BASHKËPUNIM I MIRË.....	5
FUSHA STRATEGJIKE 1 – STABILITETI DHE BANKË QENDRORE MODERNE	6
FUSHA STRATEGJIKE 2 – TRANSFORMIMI DIGJITAL DHE AFTËSI TË REJA.	7
FUSHA STRATEGJIKE 3 – TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJE PËR SUKSES TË VAZHDUESHËM.....	8
FUSHA STRATEGJIKE 4 – NDËRGJEGJËSIMI PËR EKONOMINË E QËNDRUESHME TË GJELBËR DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE.	10
FUSHA STRATEGJIKE 5 – MENAXHIMI DHE REZISTENCA NË MJEDIS TË NDRYSHUESHËM.....	11
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE	12
Shtojca 1	13
Shtojca 2	18
Shtojca 3	20
Shtojca 4	21

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesat e përdorura në Programin e Punës kanë këtë kuptim:

BPRMV-ja	Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
KG	Kabineti i Guvernatorit
ZPP	Zyra për Strategji dhe Preventivë
DAB	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
DFM	Drejtoria e Stabilitetit Financiar dhe Politikës Makroprudenciale
DRrB	Drejtoria e Rregullativave Bankare dhe Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme
DMJL	Drejtoria e Mbikëqyrjes nga Jashtë dhe Licencimit
DTM	Drejtoria e Mbikëqyrjes në Terren
DMKEF	Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Edukimit Financiar
ZMI	Zyra e Mbikëqyrjes së Sistemeve Informative
DPMH	Drejtoria e Politikës Monetare dhe Hulumtimit
DS	Drejtoria e Statistikave
DTF	Drejtoria e Operacioneve në Tregjet Financiare
DSP	Drejtoria e Sistemeve të Pagesave
DPOP	Drejtoria e Pagesave dhe Operacioneve të Prapavisë
DFKK	Drejtoria e Financave, Kontabilitetit dhe Kontrollit
DOTh	Drejtoria e Operacioneve të Thesarit
DIT	Drejtoria e Infrastrukturës të IT-së
DAP	Drejtoria e Aplikacioneve
NjMS	Njësia e mbikëqyrjes dhe sigurisë të TI-së
DBNj	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
DPJ	Drejtoria e Punëve Ligjore
DPP	Drejtoria e Prokurimit Publik
DMTS	Drejtoria e Mirëmbajtjes Teknike dhe Sigurisë
KRR	Grupe Punuese
NjO	Njësia/Njësitë Organizative
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
BE	Bashkimi Europian
BQE-ja	Banka Qendrore Europiane
MAKPAM	Modeli për Analizën e Politikave në Maqedoni
PBB	Produkti bruto i brendshëm
IPA	Instrumenti i Ndhmës së Para Aderimit
EShS	Enti Shtetëror i Statistikës
ISIDORA	Sistemi i Integruar i Raportimit nga Banka Popullore, bankat, kursimoret, për qëllime statistikore dhe mbikëqyrëse
SIK	Sistemi i integruar i kontabilitetit
TI	Teknologjia e Informacionit
SOC	Qendra e Operacioneve të Sigurisë të TI-së
LPFT	Larja e parave/ Financimi i terrorizmit
MIPS	Sistemi Ndërbankar i Pagesave të Maqedonisë
CRIS	Regjistri i Kredive (angl. Credit Registry Information for Supervision, CRIS)
KIBS	Sistemet e Kleringut Ndërbankar
AML	Parandalimi i pastrimit të parave (Anti Money Laundering)
SREP	Procesi i vlerësimit të rrezikut mbikëqyrës (Supervisory Review and Evaluation Process)
TIPS	Sistemi i shlyerjes së menjëhershme të Eurosistemit TIPS (TARGET Instant Payment Settlement – TIPS)

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 9) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21 dhe 74/24) dhe nenit 54, paragrafi (1), nënparagrafi (3) i Rregullores për planifikim strategjik dhe operativ Rr. nr. 02-15/I-1/2016 nga 28 janari 2016, Rr. nr. 02-15/VI-1/2020 nga 28 prilli 2020, Rr. nr. 02-15/IX-3/2021 nga 30 qershori 2021 dhe nr. 02-23366/5 nga 30 qershor 2023, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

**Programin e Punës
së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut
për vitin 2025**

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Programi i punës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025 (në tekstin e mëtejme: Programi i punës) përmban aktivitete programore për arritjen e kompetencave ligjore dhe fushave strategjike të përcaktuara me [Planin Strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2025 - 2027](#) nr. 02- 20029/2 nga 28 maji 2024.
2. Programi i punës ka për qëllim të sigurojë arritjen e kompetencave ligjore dhe aktiviteteve të parapara nga fushat strategjike të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) duke udhëzuar në mënyrë optimale burimet në dispozicion në fushat prioritare, duke forcuar kapacitetet në të gjitha segmentet e punës, duke përmirësuar më tej cilësinë e punës dhe duke mundësuar mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rezultateve dhe efektivitetin e masave dhe aktiviteteve të ndërmarra.
3. Aktivitetet e programit përfshijnë procese të rregullta pune dhe aktivitete në lidhje me projektet që mundësojnë futjen e ndryshimeve në operacione në drejtim të rritjes së efikasitetit, cilësisë, transparencës dhe besueshmërinë, harmonizimin me kërkesat e reja ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

AKTIVITETET PROGRAMORE

4. Aktivitetet e rregullta programore lidhen drejtpërdrejt me [kompetencat ligjore](#) dhe [fushat strategjike](#) të Bankës Popullore dhe realizohen gjatë gjithë vitit. Shpërndarja e aktiviteteve programore kryhet sipas kompetencave të përcaktuara ligjore, fushave strategjike dhe bartësve. Pasqyrë e detajuar e aktiviteteve të programit jepet në bashkëngjitjet që janë pjesë përbërëse e Programit të Punës.

Kompetencat ligjore – këto aktivitete programore kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave të rregullta të Bankës Popullore dhe mbulojnë gjashtë fusha.

KL1	Stabiliteti i çmimeve
KL2	Stabiliteti financiar, mbikëqyrja dhe ndërhyrja e jashtëzakonshme e bankave
KL3	Menaxhim me rezervat valutore
KL4	Sistemet pagesore dhe sigurimi i parave të gatshme
KL5	Hulumtime ekonomike dhe statistika
KL6	Menaxhim dhe bashkëpunim i mirë

KOMPETENCAT LIGJORE 1 – STABILITETI I ÇMIMEVE.**Aktivitetet:**

Analizat dhe projeksionet komplekse makroekonomike janë baza për zbatimin e politikave makroekonomike në kohë dhe të përshtatshme për të garantuar stabilitetin e çmimeve dhe mjedisin makroekonomik sa më të favorshëm për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik afatgjatë. Banka Popullore është duke punuar vazhdimisht në avancimin e aftësive analitike dhe forcimin e kapaciteteve për analiza dhe projeksione makroekonomike, me qëllim të menaxhimit të mëtutjeshëm të suksesshëm të politikës monetare. Avancime të mëtjeshme parashikohen në modelin MAKPAM, të cilat do të kontribuojnë në përmirësimin e fuqisë për të shpjeguar dhe projektuar lëvizjet ekonomike gjatë mriatimit të vendimeve monetare. Gjatë vitit 2025 do të vijnë aktivitetet për kontrollin dhe përmirësimin e modeleve aktuale për parashikimin afatshkurtër të PBB-së dhe inflacionit, si dhe për përmirësimin e qasjeve për parashikimin afatshkurtër të kategorive më të rëndësishme të bilancit të pagesave. Në lidhje me [operacionet monetare dhe ruajtjen e stabilitetit të kursit të denarit](#), Banka Popullore do të vazhdojë të menaxhojë likuiditetin e sistemit bankar, duke përshtatur kornizën operacionale të politikës monetare në pajtim me sfidat e jashtme dhe të brendshme. Nëpërmjet instrumenteve të ndryshme, si rregullimi i normës bazë të interesit dhe i rezervës së detyrueshme, Banka Popullore synon të ndikojë në nivelin e çmimeve dhe në stabilitetin ekonomik. Banka Popullore do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e tregut të brendshëm valutor dhe zhvillimin e [tregjeve të brendshme financiare](#), aktivitetet që do të kryhen në bashkëpunim me bankat. Rishikimi i aktiviteteve lidhur me këtë kompetencë ligjore është përfshirë në anekset e Programit të Punës për vitin 2025.



Rezultatet e pritura: Kapacitete të forcuara dhe mjete të përmirësuara për analiza dhe parashikime makroekonomike në pajtim me praktikën më të mira të vendosura nga institucionet financiare ndërkombëtare. Zbatim efikas dhe transparent i politikës monetare, ruajtje të stabilitetit të kursit nominal të denarit në raport me euron dhe stabilitet të çmimeve në afat të mesëm. Treg të brendshëm valutor dhe financiar të zhvilluar.

Bartësit: DPMH dhe DTF**KOMPETENCA LIGJORE 2 - STABILITETI FINANCIAR, MBIKËQYRJA DHE NDËRHYRJA E JASHTËZAKONSHME E BANKAVE.****Aktivitetet:**

Sigurimi i stabilitetit financiar, mbikëqyrjes dhe ndërhyrjes së jashtëzakonshme janë parakushte për ruajtjen e integritetit dhe stabilitetit të sistemit financiar. Banka Popullore, si institucioni i vetëm mbikëqyrës përgjegjës për bankat dhe kursimoreve, do të vazhdojë të zbatojë [mbikëqyrje efikase dhe të kujdesshme](#) si bazë për sistem bankar të qëndrueshëm dhe të besueshëm dhe mbrojtjen e interesave të depozituesve dhe kreditorëve të tjerë që kanë investuar fondet e tyre në banka. Në qendër të vëmendjes do të jenë aktivitetet që synojnë disa fusha: avancimin e rregullimit bankar dhe ndërhyrja e jashtëzakonshme e bankave, zbatimin e mandatit makroprudencial të Bankës Popullore, mbikëqyrjen e lëvizjeve dhe rreziqeve në sistemin financiar, vlerësimin e rezistencës së sistemit bankar ndaj goditjeve, forcimin e mbikëqyrjes nga jashtë dhe në terren, vlerësimin e rrezikut të TI-së dhe sigurisë kibernetike, si dhe forcimi i sistemit të mbrojtjes së konsumatorit në sistemin bankar. Në të njëjtën kohë, praktikën mbikëqyrëse dhe kuadri metodologjik për përdorimin e testimit të stresit do të përmirësohen, para së gjithash, në procesin e vlerësimit mbikëqyrës të profilin e rrezikut të bankave. Rishikimi i aktiviteteve lidhur me këtë kompetencë ligjore është përfshirë në anekset e Programit të Punës për vitin 2025.



Rezultatet e pritura: Sistem bankar i qëndrueshëm dhe rezistent ndaj rreziqeve të jashtme dhe të brendshme. Kornizë rregulluese e cila mundëson sistem bankar tregtar dhe konkurrues, në pajtim me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare më të mira. Mbikëqyrje e pavarur, e matur dhe efikase që mundëson mbrojtjen efektive të përdoruesve të shërbimeve financiare.


Bartësit: DBR, DFM, ZMI, DMJL, DMT, DMKEF.

KOMPETENCA LIGJORE 3 - MENAXHIMI I REZERVAVE VALUTORE.

Aktivitetet:



Banka Popullore [menaxhon me rezervat valutore](#) të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke ofruar kështu mbështetjen e zbatimit të politikës monetare dhe regjimit të kursit të këmbimit, mbrojtjen e ekonomisë vendase nga goditjet e jashtme, pagesën e rregullt të borxhit të jashtëm publik dhe ruajtjen e besueshmërisë së ekonomisë së brendshme në kuadrin ndërkombëtar. Gjatë menaxhimit me rezervat valutore, Banka Popullore i përshtat vendimet për investime sipas zhvillimeve të ndryshueshme të tregut vendas valutator dhe tregjeve financiare ndërkombëtare, duke u udhëhequr nga parimet e sigurisë, likuiditetit dhe kthimit nga menaxhimi. Gjatë vitit 2025 do të vijnë aktivitetet për zbatimin e plotë të modeleve të biznesit për portofolet individuale për fleksibilitet më të madh në menaxhimin e rezervave valutore. Gjithashtu do të punohet në përgatitjen e metodologjive dhe përgatitjen e propozimit për aktivitetet e projektit për futjen e instrumenteve të reja dhe/ose palëve kontraktuese. Rishikimi i aktiviteteve lidhur me këtë kompetencë ligjore është i përfshirë në anekset e Programit të Punës për vitin 2025.



Rezultatet e pritura: Menaxhimi efikas me rezervat valutore gjatë baraspeshës optimale mes parimeve të sigurisë, likuiditetit dhe kthimit nga menaxhimi.

Bartës: DTF.

KOMPETENCA LIGJORE 4 - SISTEMET PAGESORE DHE SIGURIMI I PARAVE TË GATSHME

Aktivitetet:



Banka Popullore ka rol thelbësor në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e [sistemeve të pagesave](#) dhe [sigurimin e parave të gatshme](#) për të mundësuar funksionimin normal të ekonomisë. Banka Popullore do të vazhdojë me aktivitetet e ruajtjes së integritetit dhe besimit në njësinë monetare kombëtare përmes funksionalitetit, stabilitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të vendosur në sistemin e furnizimit të parave të gatshme dhe sigurimin e cilësisë së lartë standarde të monedhave dhe kartëmonedhave në qarkullim. Për më tepër, Banka Popullore do të vazhdojë të mbikëqyr shpërndarjen dhe menaxhimin e parave të gatshme për të përmbushur kërkesat e bizneseve dhe konsumatorëve duke u mbrojtur nga falsifikimi dhe aktivitetet ilegale.

Në fushën e sistemeve të pagesave dhe shërbimeve të pagesave, mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit të ri ligjor do të vazhdojë në vitin 2025 në sferën e pagesave, dhe do të mundësojë futjen e teknologjive dhe inovacioneve të reja për të mbështetur pagesat për popullatën dhe sektorin e korporatave. Paralelisht, do të vazhdohet mbikëqyrja e ndërmjetme dhe e drejtpërdrejtë e operatorëve të sistemit të pagesave për të siguruar realizim të sigurt dhe efikas të pagesave dhe harmonizimin e mëtejshme me standardet dhe kërkesat ndërkombëtare në këtë fushë. Në këtë kontekst, pjesëmarrja aktive e Bankës Popullore në zhvillimin e

Strategjisë për zhvillimin e sistemit të pagesave të Republikës së Magedonisë së Veriut. Gjithashtu, do të vazhdojë avancimi i operacioneve në sfond në pajtim me standardet e Bankës Qendrore Europiane dhe forcimi i procedurave operacionale dhe sistemeve të rëndësishme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Banka Popullore do të vazhdojë të ndërmarrë aktivitete për ruajtjen e besueshmërisë, stabilitetit dhe efikasitetit të shlyerjes së transaksioneve të lidhura me qëllim të zbatimit të politikës monetare dhe menaxhimit të rezervave devizore. Në tërësi, aktivitetet e parapara do të kontribuojnë në ruajtjen e integritetit, efikasitetit dhe sigurisë së sistemeve të pagesave. Rishikimi i aktiviteteve lidhur me këtë kompetencë ligjore është përfshirë në anekset e Programit të Punës për vitin 2025.



Rezultatet e pritura: Nivel i lartë i integritetit dhe besimit në njësinë monetare kombëtare. Sistem pagese i sigurt, i qëndrueshëm dhe efikas, si dhe përfshirje më e madhe dhe mbrojtje më e mirë e përdoruesve të shërbimeve të pagesave.

Bartësit: DOTH, DSP dhe DPOP.

KOMPETENCA LIGJORE 5 -HULUMTIME EKONOMIKE DHE STATISTIKA

Aktivitetet:



Aktivitet hulumtues dhe menaxhim i të dhënave statistikore edhe në vitin 2025, këto do të jenë fushat në të cilat Banka Popullore do të punojë dhe përmirësohet me përkushtim, duke pasur parasysh rëndësinë e tyre për të gjithë publikun dhe në mbështetjen e proceseve në Bankën Popullore në marrjen e vendimeve në kohë dhe cilësore në fushën e politikës monetare dhe makroprudenciale. Zhvillimi i një baze të dhënash të pasur dhe të larmishme me të dhëna statistikore i mundëson Bankës Popullore të mbikëqyr dhe vlerësojë gjendjen e përgjithshme të ekonomisë, përcakton trendet e reja dhe rreziqet e mundshme. Me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe saktësisë së këtyre të dhënave, Banka Popullore do të vazhdojë të zhvillojë mundësitë për mbledhjen, analizën, përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Gjithashtu, Banka Popullore do të angazhohet plotësisht në përmbushjen e detyrimeve ndaj partnerëve ndërkombëtarë në fushën e statistikave dhe do të punojë për harmonizimin e të dhënave me standardet dhe praktikën më të larta botërore. Gjatë vitit 2025, Banka Popullore do të vazhdojë të zhvillojë teknikat e hulumtimit dhe modelimit ekonomik, duke avancuar fushën e analizave makroekonomike, e cila gjithashtu kontribuon në avancimin dhe pasurimin e veprimtarisë shkencor-hulumtuese brenda dhe jashtë vendit. Në baza të rregullta do të vazhdojë organizimi i seancave të rregullta tremujore të Klubit të Hulumtuesve, si mundësi për të shkëmbyer përvoja me publikun në fushën e makroekonomisë dhe tema të tjera të operacioneve të bankës qendrore. Me hulumtimet ekonomike dhe statistikën e Bankës Popullore synohet transparencë, llogaridhënia dhe vendimmarrja mbi baza të informacionit. Avancimi i funksionit statistikor do të synojë përmbushjen e plotë të standardeve europiane për cilësinë dhe afatin kohor të të dhënave statistikore, publikimin e grupeve të reja të të dhënave statistikore (kryesisht për llogaritë financiare) dhe rritjen e efikasitetit përmes digjitalizimit më të madh të proceseve. Rishikimi i aktiviteteve lidhur me këtë kompetencë ligjore është përfshirë në anekset e Programit të Punës për vitin 2025.



Rezultatet e pritura: Disponueshmëri e të dhënave statistikore me cilësi të lartë, në kohë dhe lehtësisht të qasshme, të cilat janë të krahasueshme ndërkombëtarisht. Teknika moderne hulumtuese, veprimtari e pasur shkencor-hulumtuese për fusha të ndryshme ekonomike dhe debate të

frytshme akademike për të mbështetur procesin e vendimmarrjes në fushën e politikës monetare dhe stabilitetit financiar.

Bartës: DPMH dhe DS

KOMPETENCA LIGJORE 6 - UDHËHEQJA E MIRË DHE BASHKËPUNIMI


Aktivitetet:



Në kuadër të kësaj kompetence ligjore janë paraparë disa aktivitete nën autoritetin e funksioneve mbështetëse, të cilat me veprimin e tyre mundësojnë kryerjen pa probleme të funksioneve dhe detyrave të Bankës Popullore për realizimin efikas të objektivave të përcaktuara strategjike, mandatit dhe vizionit. Banka Popullore, si institucion me interes publik, do t'i përkushtohet më tej efektivitetit të [menaxhimit të rrezikut](#) në të gjitha segmentet e veprimtarisë së saj, duke respektuar standardet më të larta për [udhëheqje korporative](#) dhe raportimin financiar. Banka Popullore do të marrë masa për të forcuar [sigurinë e sistemit të informacionit](#), rezistencën e kërcënimeve kibernetike dhe sigurimin e vazhdimësisë së punës, mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e informacionit të klasifikuar. Përveç të lartëpërmendurës, Banka Popullore menaxhon me kujdes rreziqet ligjore dhe vazhdimisht ndërmerr aktivitete për [përputhshmërinë dhe normat etike](#) për të ruajtur standardet më të larta të integritetit dhe llogaridhënies. Përmes procedurave [gjithëpërfshirëse të auditimit në kuadër të auditimit të brendshëm](#), Banka Popullore siguron efikasitet në punën e saj. Në të njëjtën kohë, Banka Popullore mbetet e përkushtuar për sigurinë dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të infrastrukturës së saj në mënyrë që të mbështesë mandatin e bankës. Gjithashtu do të vazhdojë me avancimin e vazhdueshëm të procesit të mirëmbajtjes së infrastrukturës së TI-së dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve të TI-së përmes zbatimit të sistemeve, mjeteve dhe procedurave më të fundit dhe më të përshtatshme.

Avokimi për udhëheqje të mirë dhe inkurajimi i [bashkëpunimit institucional](#) brenda sistemit financiar siguron stabilitet dhe efikasitet. Banka Popullore bashkëpunon me [institucione ndërkombëtare](#), organizatat, organet rregullatore dhe palët tjera të interesuara vendore dhe ndërkombëtare për të koordinuar miratimin e rregulloreve dhe zbatimin e praktikave më të mira. Me bashkëpunimin aktiv ndërinstitucional, Banka Popullore kontribuon në stabilitetin e ekonomisë, zbatimin e suksesshëm të politikës monetare dhe ndërtimin e ekonomisë të qëndrueshme. Banka Popullore, në të njëjtën kohë, kontribuon në realizimin e interesave kombëtare për [aderimin në Bashkimin Europian dhe institucionet europiane](#) duke kontribuar në zhvillimin dhe zbatimin e të gjitha dokumenteve strategjike. Gjithashtu, Banka Popullore do të vazhdojë me harmonizimin e operacioneve të saj, duke zbatuar në mënyrë aktive rregulloren në të cilën është inkorporuar legjislacioni europian, si dhe sipas standardeve dhe praktikave më të mira botërore dhe europiane.

Banka Popullore do të vazhdojë me aktivitetet për [njoftimin e publikut](#), që do të mundësojë disponueshmërinë dhe shpërndarjen në kohë të informatave dhe të dhënave të nevojshme, me arsyetim të duhur për masat e ndërmarra. Banka Popullore do të përpaket për përmbushjen e [Planit Strategjik](#) përmes realizimit të suksesshëm të aktiviteteve dhe projekteve të planifikuara. Në kuadër të kësaj kompetence, aktivitetet që do të ndërmerren për avancimin e proceseve për planifikimin, realizimin dhe mbikëqyrjen e [prokurimit publik](#), zhvillimin e [punës muzeale](#), [veprimtarisë bibliotekare dhe arkivoro-historike](#) si kontribut në promovimin e vlerave kombëtare dhe shoqërore të vendit tonë. Baza për zbatimin e suksesshëm të të gjitha aktiviteteve të përmendura më parë është siguri i [potencialit njerëzor](#) kompetent në mënyrë që të vazhdojë të kujdeset për tërheqjen, mbajtjen dhe motivimin e stafit të përkushtuar dhe profesional. Pasqyra e aktiviteteve lidhur me këtë kompetencë ligjore është përfshirë në anekset e Programit të Punës për vitin 2025.



Rezultatet e pritura: Realizim i papenguar i funksioneve dhe detyrave të Bankës Popullore për realizimin efikas dhe efektiv të përcaktimeve, mandatit dhe vizionit të përcaktuar strategjik.

Bartësit: ZSP, DRrZB, DAB, KG, DFKK, DPP, Muzeu, Biblioteka dhe Arkivi, DIT, NjMS, DBNj.

Fushat strategjike – këto aktivitete programore kanë të bëjnë me kryerjen e detyrave të rregullta të Bankës Popullore dhe mbulojnë pesë fusha.

FS1	Stabilitet dhe bankë qendrore moderne
FS2	Transformim digjital dhe aftësi të reja
FS3	Transparencë dhe përfshirje për sukses të vazhdueshëm
FS4	Ekonomi të qëndrueshme të gjelbër dhe ndërgjegjshmëri për ndryshimet klimatike
FS5	Menaxhim dhe rezistencë në mjedis të ndryshueshëm

FUSHA STRATEGJIKE 1 - STABILITETI DHE BANKA QENDRORE MODERNE

Aktivitetet:



Në kuadër të kësaj fushe strategjike, Banka Popullore do të vazhdojë të ndërmarrë aktivitete për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, financiare dhe avokimin e vlerave të një banke qendrore moderne. Përmes harmonizimit me praktikën më të mirë në eurosistem, aktivitetet për modernizimin e instrumenteve monetare dhe planifikimi i likuiditetit për transmetim më efikas të sinjaleve monetare. Gjatë vitit 2025 do të vazhdojnë aktivitetet e filluara për ndryshimin e përcaktimit të sistemit të rezervës së detyrueshme për të mbështetur procesin e denarizimit. Gjithashtu parashikohet përmirësimi i mëtejshëm i funksionimit dhe transparencës së tregut valutor në pajtim me rekomandimet e bashkëpunimit teknik me FMN-në. Në pajtim me detyrën ligjore të Bankës Popullore si agjent fiskal dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, do të fillohet me aktivitetet për modernizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit elektronik për zhvillimin e ankandeve të LQV-ve në tregun vendas. Njëkohësisht do të përfundojë përgatitja e Ligjit të ri të Bankave në harmonizim me direktivat e BE-së dhe përgatitja e akteve nënligjore përkatëse.

Për të nxitur inovacionin dhe konkurrencën në sektorin financiar dhe në të njëjtën kohë të përmirësojë qasjen në shërbimet financiare, Banka Popullore do të kryejë disa aktivitete që synojnë mbështetjen e zhvillimit të sektorit vendor të fintekut. Me qëllim të krijimit të një sistemi efikas për mbrojtjen e konsumatorëve, janë planifikuar aktivitete për forcimin e kuadrit rregullator për mbrojtjen e konsumatorëve në sektorin bankar, si dhe për thellimin e bashkëpunimit me institucionet financiare duke krijuar rrjet personash kontaktues për mbrojtjen e konsumatorit.

Banka Popullore vazhdon të inkurajojë inovacionin në sistemet pagesore, shërbimeve pagesore duke përdorur përparimin e vazhdueshëm teknologjik për të përmirësuar efikasitetin dhe sigurinë në transaksionet financiare. Në qendër të vëmendjes do të jenë aktivitetet e projektit për avancimin e zgjidhjeve softuerike të krijuara në shërbimet e pagesave dhe sistemet e pagesave për shkak të rritjes së transparencës dhe krahasueshmërisë së shërbimeve, për shkak të konkurrencës më të madhe dhe mbrojtjes së konsumatorit. Për këtë qëllim janë edhe aktivitetet në kuadër të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal për krijimin e një tregu të përbashkët rajonal i cili do të ndihmojë vendet e Ballkanit Perëndimor për integrim më të shpejtë në Zonën

e vetme europiane të pagesave (SEPA), gjë që do të çonte në pagesa ndërkufitare më të lira, më të shpejta dhe më të përshtatshme për kompanitë dhe qytetarët. Gjithashtu, do të rishqyrtohen mundësitë për prezantimin e zgjidhjeve inovative të fintekut për kryerjen e pagesave, si dhe të lidhjes me sistemin e shlyerjes së pagesave të menjëhershme (TIPS) të Eurosistemit. Banka Popullore do të vazhdojë t'i perceptojë mundësitë dhe nevojën për emetimin e denarit digjital për t'u mundësuar qytetarëve dhe kompanive në epokën digjitale qasje të lehtë në paratë e lëshuara nga Banka Popullore. Në vitin 2025, në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Holandës, do të organizohet Konferenca e 16-të për Pagesat dhe Infrastrukturën e Tregut i cili do të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe operatorëve të sistemeve të pagesave duke informuar për të rejat në fushën e shërbimeve të pagesave në nivel botëror dhe europian. Rishikimi i aktiviteteve lidhur me këtë fushë strategjike është përfshirë në anekset e Programit të Punës për vitin 2025.



Rezultatet e pritura: Kuadër funksional modern i politikës monetare, përmirësim i funksionimit të tregut valutor, forcim i stabilitetit dhe elasticitetit të sistemit bankar, mbikëqyrje, ndërhyrje e bankave dhe mbrojtje e konsumatorit, sektor i zhvilluar vendas i fintekut dhe qasje më e mirë në shërbimet financiare, sistemet inovative të pagesave dhe shërbimet e pagesave, pagesa ndërkufitare më të lira, më të shpejta dhe më të përshtatshme për kompanitë dhe qytetarët.

Bartësit: DTF, DBR, GP për fintek, ZMI, DSP dhe DMKEF.

FUSHA STRATEGJIKE 2 – TRANSFORMIMI DIGJITAL DHE AFTËSI TË REJA.

Aktivitetet:



Në vitin 2025, Banka Popullore do t'i përkushtohet digjitalizimit dhe automatizimit të detyrave të punës duke zhvilluar mjete inovative softuerike, të cilat do të kontribuojnë në racionalizimin e proceseve të punës dhe në rritjen e efikasitetit të saj në operacione. Duke ecur në rrugën drejt transformimit digjital, Banka Popullore do të vazhdojë të punojë me përkushtim në projektet e nisura për krijimin e sistemit të integruar, të detajuar dhe efikas të raportimit nga Banka Popullore, bankat dhe kursimoret për qëllime statistikore dhe mbikëqyrëse (ISIDORA) dhe ndërtimin e skedarit të vetëm të të dhënave statistikore dhe zbatimin e mjeteve moderne dhe efikase në përgatitjen e të dhënave statistikore në pajtim me kërkesat dhe standardet e BE-së. Gjithashtu do të vazhdojë me ngritjen e sistemit të ri të integruar të kontabilitetit ISS - libri kryesor, si dhe më shumë zgjidhje aplikative të kontabilitetit dhe përmirësime të sistemit të kontabilitetit të Bankës Popullore. Është planifikuar të prezantohet një platformë për menaxhimin e integruar të parave, e cila do të rrisë shkallën e automatizimit të proceseve të cilat zhvillohen në Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit, me çka do të përmirësojë të gjitha aktivitetet që përfshijnë ciklin e parasë së gatshme dhe do të krijohet sistem modern për furnizimin me para të gatshme dhe për përpunimin e kartëmonedhave dhe monedhave.

Në vitin 2025, do të prezantohet mënyrë moderne e nënshkrimit digjital të skedarëve, e cila funksionon në të gjithë shfletuesit modernë të internetit, duke siguruar kështu vazhdimësinë në funksionimin e të gjitha aplikacioneve të zhvilluara në Bankën Popullore, dhe rrjedhimisht funksionimin pa probleme të një numri të madh të proceseve në institucion. Gjithashtu, planifikohet prezantimi i i inteligjencës artificiale si mbështetje e punës në kuadër të detyrave të punës ditore, si dhe futjes së mjeteve për kontrollin e sigurisë së kodit softuerik. Aktivitetet që lidhen me projektin në periudhën afatmesme synojnë gjithashtu modernizimin e proceseve të punës për krijimin e sistemeve të produktivitetit që janë bazë për përdorimin e burimeve të resë kompjuterike (angl. Cloud computing).

Në plan janë edhe aktivitetet e përpërmirësimit të njohurive për menaxhimin e të dhënave duke shfrytëzuar fuqinë e teknologjive të fundit dhe duke forcuar aftësitë analitike. Për këtë qëllim, Banka Popullore do të investojë në trajnimin e punonjësve me aftësi të reja, duke forcuar potencialin dhe kapitalin e saj njerëzor dhe duke siguruar gatishmërinë për zhvillimin dhe sfidat e ardhshme në fushën e bankave dhe financave. Në këtë kontekst, parashikohet avancimi i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore duke prezantuar proces të ri të menaxhimit të stafit të talentuar dhe mbajtjes së punonjësve potencialë.



Rezultatet e pritura: Rritje e efikasitetit të operacioneve duke automatizuar dhe digjitalizuar shumë procese dhe detyra pune të përsëritshme. Analizë më e mirë e sasisë së madhe të të dhënave dhe sistem i avancuar i kontabilitetit. Sistem efikas, i thjeshtë dhe i detajuar për dërgimin e të dhënave në Bankën Popullore, harmonizimin e statistikave zyrtare me sfidat që dalin nga transformimi digjital. Krijim i një sistemi modern për furnizimin me para të gatshme dhe për përpunimin e parave të letrës dhe monedhave. Rritja e mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave nga incidentet (sulme hakerimi, vjedhje të të dhënave dhe forma të tjera të krimit kibernetik), si dhe sigurimin e kodit cilësor për zbulimin në kohë të gabimeve dhe dobësive të mundshme. Punonjës të kualifikuar dhe të motivuar me aftësi të larta profesionale, zhvillim të drejtuesve dhe menaxherëve dhe sistem të krijuar për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Bartësit: DS, DOTH, DFKK, DIT, DAP dhe DBNj.

FUSHAT STRATEGJIKE 3 – TRANSPARENCA DHE PËRFSHIRJA PËR SUKSES TË VAZHDUESHËM.

Aktivitetet:



Banka Popullore do të vazhdojë me aktivitetet për përmirësim të vazhdueshëm të [transparencës](#) dhe disponueshmërinë e informacionit, duke inkurajuar komunikimin dhe në kohë [informimin e publikut](#), si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të brendshëm. Për këtë qëllim, është parashikuar thjeshtimi dhe pasurimi i teksteve informative të disponueshme në faqen e internetit, në fushat e veprimtarisë së Bankës Popullore të cilat janë në pajtim me rekomandimet e Raportit të misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të kryera në kuadër të Kodit të Transparencës. Parashikohet edhe rritje e pranisë në rrjetet sociale përmes formave moderne të prezantimit, si dhe një projekt për ridizajnimin e faqes së internetit të Bankës Popullore. Me qëllim të njohjes së publikut me punën e Bankës Popullore, do të organizohet ngjarja "Ditë e hapur në Bankën Popullore - Banka jonë Popullore", si dhe organizimin e një konference të nivelit të lartë si platformë për përpunimin e temave përkatëse me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare dhe publikun vendas. Gjithashtu do të vazhdojë me zbatimin e standardeve më të larta për transparencë dhe qartësi në përmbushjen e detyrimeve ligjore për [raportimin financiar dhe operacionet e bankës qendrore](#).

Vend qendror në këtë fushë është përkushtimi ndaj [edukimit financiar](#), që synon rritjen e edukimit financiar dhe përfshirjes së popullsisë. Janë planifikuar më shumë aktivitete edukative dhe organizime të ngjarjeve që do të sigurojnë ngritjen e vetëdijes financiare dhe edukimit që do të mundësojnë shkallë më të lartë të përfshirjes financiare të popullatës. Në qendër të vëmendjes të këtij qëllimi strategjik do të jetë zbatimi dhe rishikimi i [Strategjisë për edukim financiar dhe përfshirje financiare të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2021 - 2025](#). Një nga masat dhe aktivitetet në Strategjinë për edukim financiar dhe përfshirje financiare 2021 - 2025 përfaqëson gjithashtu edukimin dhe përfshirjen e grupeve vulnerabël në shoqëri me qëllim edukimin e tyre të duhur dhe informimin më të mirë në fushën e financave. Në të njëjtën kohë, si kontribut në promovimin e vlerave kombëtare dhe shoqërore të vendit tonë, janë planifikuar aktivitetet për [edukimin muzeor](#) dhe [punë hulumtuese muzeore](#).

